



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I28-2 Prot.
Nr. Dok. 202502606/

Tiranë 25 /08 /2025

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Lezhë.*

Drejtuar: Z. Ulsi MANJA
Ministër i Drejtësisë

TIRANË

Znj. Albana KOÇIU
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

TIRANË

Z. Klevis Qose
Drejtore i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Për dijeni: Znj. Valentin MACAJ
Drejtore i I.E.V.P Lezhë

LEZHË

Të nderuar,

Avokati i Popullit, vlerëson bashkëpunimin e deritanishëm, angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona. Në vijim po ju njohim mbi inspektimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në institucionin tuaj në datë 03.04.2025.

Inspektimi u krye nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 31 të ligjit nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", i ndryshuar, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2025 të miratuar nga Avokati i Popullit, me qëllim vlerësimin e progresit të bërë që nga vizita e fundit e MKPT-së në vitin 2024.

Qëllimi i vizitës inspektuese, kishte të bënte me monitorimin e situatës së trajtimit dhe respektimit të të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor të transferuar në këtë institucion, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”, Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore” ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) të nënshkruar më datë 23.11.2021, si dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë për këtë qëllim. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj Nertila Qafzezi, z. Hazbi Selita dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Institucioni i Avokatit të Popullit ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë gjetjet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Avokati i Popullit në vite i ka kushtuar një rëndësi të veçantë mbikëqyrjes të situatës së respektimit të të drejtave dhe lirive të personave që vuajnë nga sëmundje dhe çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore. Për kujtesë këta pacientë janë transferuar në datat 27 dhe 28 nëntor 2021 nga Institucioni i Posaçëm për të Burgosurit Mendor III Zaharia në Krujë në ambientet e hapura në Burgun Lezhë, si dhe në IVSHB (Spitali i Burgjeve), Tiranë, apo janë të akomoduar në sektorët e kujdesit të veçantë pranë institucioneve të ekzekutimit të dënimeve penale, ashtu si edhe në spitale/pavione psikiatrike me shtretër.

Ligji nr. 81/2020, pika 2, neni 15 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”¹ dhe Ligji nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, konkretisht, në nenin 28, pika 2² të këtij ligji, kanë përcaktuar qartë se, trajtimi shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht veprës penale që kanë kryer dhe për të cilët gjykata kompetente ka vendosur masën “mjekim i detyruar” apo “shtrim i përkohshëm”, duhet të kryhet në një Institucion të Posaçëm Mjekësor, pjesë e sistemit shëndetësor të integruar, dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar.

Mbyllja e të dënuarve me probleme të shëndetit mendor në institucione të veçanta brenda sistemit penitenciar, përbën cenim të rëndë të të drejtave të tyre, e për këtë qëllim e

¹ Institucionet e kujdesit shëndetësor për personat për të cilat gjykata ka vendosur zbatimin e masave mjekësore të detyrueshme administrohen nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin mendor, për sa i takon ofrimin e shërbimeve. Masat e sigurisë për ruajtjen e këtyre institucioneve ofrohen nga Ministria e Drejtësisë.

² Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

vlerësojmë të rëndësishëm faktin që IEVP Lezhë konsiderohet “institucion tranzitor”, deri në konkretizimin e hapave për ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor.

“Marrëveshja e bashkëpunimit për trajtimin e personave me çrregullime mendore me masë mjekësore” e vitit 2021, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka përshkruar përgjegjësitë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në lidhje me pacientët e mbajtur në ambientin e përkohshëm si: ofrimi i shërbimeve të specializuara të mbështetjes psikiatrike, diagnostifikimi dhe ekzaminimet laboratorike.

Lidhur me zbatimin e marrëveshjes, është ngritur grup pune me Urdhrin e përbashkët nr.53, datë 31.01.2024 ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.590, Prot datë 31.01.2024 dhe Ministrisë së Drejtësisë nr.669, Prot datë 02.02.2024, *“Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e planit të përbashkët të veprimit për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, aneks i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe monitorimi i zbatimit të tyre”*.

Marrëveshja e bashkëpunimit e vitit 2021 thekson shprehimisht se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për ndërtimin, planifikimin dhe menaxhimin e Institucionit Mjekësor të Posaçëm të ardhshëm. Ndërkohë, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për administrimin dhe sigurinë e objektit të përkohshëm.

Nga biseda me drejtuesin dhe stafin e I.E.V.P Lezhë konstatuam se kjo marrëveshje nuk ka gjetur zbatim edhe pse numri i shtetasve me masë mjekësore vijon të rritet vit pas viti në I.E.V.P. Lezhë. Gjithashtu na u bë me dije se nuk është zbatuar dhe nuk ka gjetur mbështetje nga Spitali Rajonal Lezhë përgjatë nevojave për konsulta të specializuara apo në rastet e emergjencave mjekësore. Sjellim në vëmendje se ky është detyrim që rrjedh nga Udhëzimi i Përbashkët nga Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shëndetësisë dhe mbrojtjes Sociale Nr.1 datë 17.03.2023, *“ Për Diagnostikimin dhe Mjekimin pranë qendrës Spitalore Universitare dhe Institucioneve Spitalore Rajonale, si dhe përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit Shëndetësor dhe funksionimin e skemës së sigurimeve Shëndetësore për personat e Burgosur”*. Në udhëzim përcaktohet se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale siguron:

- Realizimin e konsultave të zgjeruara në shërbimet përkatëse të Qendrës Spitalore Universitare për të Burgosurit me sëmundje komplekse dhe në gjendje të rënduar Shëndetsore në rastet kur është ezauruar ofrimi i shërbimit në institucionet spitalore rajonale.

Në aktet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare të miratuara dhe të ratifikuara nga legjislativi shqiptar, përcaktohet qartë se, shtetasit për të cilët është dhënë masa

mjekësore “Mjekim i detyruar” dhe “Shtrim i përkohshëm”, nuk duhet të jenë të akomoduar në IEVP në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, por ata duhet të trajtohen në një Institucion të Posaçëm Mjekësor në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Komiteti për Parandalimin e Torturës në Këshillin e Evropës (KPT) gjatë vizitës së tij në Shqipëri në 4-15 Maj 2023, pati në fokus të vazhdueshëm edhe gjendjen e pacientëve psikiatrikë ligjorë dhe të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor. Në raportin datë 24 nëntor 2023, me rekomandime drejtuar Qeverisë Shqiptare, ka shprehur edhe një herë rezerva në lidhje me ngritjen e Institucionit Mjekësor të Posaçëm duke theksuar se: **“KPT-ja dëshiron të informohet për statusin aktual në lidhje me planifikimin, financimin, planet fizike dhe personelin e ardhshëm të institucionit të posaçëm mjekësor të ardhshëm, si dhe planet e autoriteteve shqiptare në lidhje me ndryshimet legislative, të lidhura me nenin 46 të Kodit Penal dhe hapjen e ambienteve të kujdesit ambulator për pacientët psikiatrikë ligjorë”**.³

Raporti i KPT-së është i një rëndësie të veçantë për shtetet të cilat kanë ratifikuar “Konventën Evropiane kundër Torturës dhe Dënimeve, a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore, ose Degraduese”. KPT kryen vizita në vendet ku privohet liria, në mënyrë që të monitorojë se si trajtohen personat të cilëve ju është privuar liria, në institucionet si: burgje, qendrat e paraburgimit për të miturit, komisariatet e policisë, qendrat e mbajtjes së migrantëve, spitalet psikiatrike, shtëpitë e kujdesit social, etj.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) seksion i Avokatit të Popullit, që nga momenti i bërjes publike të raportit të KPT-së (24 nëntor 2023), në inspektimet periodike të kryera pranë këtyre institucioneve në vijimësi po monitoron hapat e ndjekura nga institucionet për zbatimin e rekomandimeve të KPT-së.

Në raportin e KPT-së të vitit 2023 vazhdojnë të trajtohen me përparësi kushtet në burgje, sigurimi i një mjedisi më të përshtatshëm dhe të personalizuar për pacientët me masë mjekësore, heqja e shtretërve marinar, ushtrimet e përditshme në natyrë në një kohë më të zgjatur, mungesa e stafit mjekësor, mungesa e rregullores, mjetet mjekësore të amortizuara ose në mungesë, kontakti me botën e jashtme, trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm i stafit për parandalimin e dhunës, përmirësimi i praktikës së përdorimit të mjeteve kufizuese, etj.

Rekomandimet e KPT-së janë një garanci për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe për rrjedhojë duhet të bëhen pjesë integrale e punës së përditshme të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre. Monitorimet e vazhdueshme të institucionit të Avokatit të Popullit sjellin në mënyrë të vazhdueshme në vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse rëndësinë e marrjes së masave dhe zbatimit të rekomandimeve të KPT-së, zbatimi i të cilave mbetet në masë të ulët. Implikimet buxhetore në shumicën e rasteve kanë sjellë një ritëm të ulët ose dhe pamundësinë në zbatimin e rekomandimeve dhe për pasojë kanë sjellë kushte dhe trajtim çnjerëzor në respektimin e të drejtave të njeriut.

³ CPT Report 2023, faqet 5,35,36,37,38,39, si dhe faqet 45,46,47,48 <https://rm.coe.int/1680ae233b>

Moszbatimi i përpiktë i rekomandimeve të KPT-së sjell për pasojë mosrespektimin/shkeljen e standardeve të kërkuara dhe gjithëpranuara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Pavarësisht presionit të Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare dhe atyre vendase, si dhe disa përpjekjeve nga ana e qeverive ndër vite, për të ndërtuar një institucion të veçantë për personat me masë mjekësore me vendim gjykate, ende edhe sot nuk është arritur asnjë rezultat konkret, përfshirë këtu edhe mos miratimin e VKM-së në zbatim të nenit 28/2 të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor” i ndryshuar.

Sa i takon zbatimin të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i një viti më parë në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë, rezultoi se:⁴

Ishin zbatuar rekomandimet:

- Ishin marrë masat pjesërisht për shtimin e numrit të personelit të kujdesit shëndetësor duke përfshirë mjekë psikiatër dhe sigurimin e pranisë së një psikiatri gjatë gjithë kohës brenda vitit 2024.
- Ishin marrë masat për vënien në funksionim të laboratorit klinik bio-kimik, me blerjen e materialeve mjekësore të nevojshme për kryerjen e analizave mjekësore.
- Ishin marrë masat pjesërisht për rritjen profesionale të kapaciteteve të shërbimit psiko-social nëpërmjet trajnimeve të terapeutistëve dhe psikologëve nga ana klinike, si dhe infermierëve të mirë trajnuar në shëndetin mendor me qëllim rritjen e cilësisë të shërbimeve ndaj personave me masë mjekësore, të cilët në situatën aktuale gjenden para një braktisje terapeutike.
- Ishin marrë masat nga Sektori Ligjor për hartimin dhe dërgimin e dosjeve të personave me masë mjekësore që kanë mbushur afatet për rivlerësimin vjetor nga gjykata për gjendjen e tyre shëndetësore.

Ndërkohë, nga inspektimi rezultoi se **nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:**

- Nuk ishin marrë masat për hartimin/miratimin e rregullores së funksionimit të Institucionit Tranzitor Lezhë, deri në ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor.
- Nuk ishin marrë masa për uljen e mbipopullimit në këtë institucion duke siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, sigurimin e shtretërve të plotë dhe kushtet higjieno-sanitare brenda vitit 2024.

⁴. Rekomandimi nr. K1/I28-2 datë 29.07.2024.

- Nuk ishin marrë masat për angazhimin e stafit psiko-social në bashkëpunim me mjekët psikiatër duke vepruar si një ekip multidisiplinar, për përcaktimin e planeve individuale për pacientin dhe organizimin e një karte të përbashkët për pacientin për të bërë të mundur një rishikim të rregullt të gjendjes së shëndetit mendor të pacientit dhe një rishikim të mjekimit të pacientit.
- Nuk ishin marrë masat e nevojshme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, në Planin e Veprimit të përbashkët për trajtimin e personave me masë mjekësore, për detajimin e aktiviteteve specifike me afate kohore konkrete, sipas angazhimeve të marra në marrëveshjen e përbashkët, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
- Nuk ishin marrë masat nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për gjetjen e hapësirave për hartimin e akteve nënligjore dhe administrative për kalimin e personave të braktisur nga familjarët që qëndrojnë në IEVP Lezhë në godinat 4 dhe 5 të cilat duhet të kalojnë në kujdesin e strukturave dhe qendrave të kujdesit social shtetëror.
- Nuk ishin marrë masa për planifikimin e ngritjes dhe funksionimit të Institucionit Mjekësor të Posaçëm, si strukturë e posaçme për ofrimin e një kujdesi terapeutik, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, si dhe informimin e institucionit tonë në lidhje me Planin e Veprimit të përbashkët për trajtimin e personave me masë mjekësore, për detajimin e aktiviteteve specifike me afate kohore konkrete, sipas angazhimeve të marra në marrëveshjen e përbashkët, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në përgjigje të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2024, me shkresën nr.13423/1 prot, datë 01.10.2024 na informon se me Urdhërin Nr.68 datë 30.04.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj” të Kryeministrit ku: Institucion i Ekzekutimit të Vendimeve Penale kalon në Institucion Mjekësor i Posaçëm IEVP Lezhë. Në lidhje me strukturën organike bëjnë me dije se më datën 01.07.2024 ka hyrë në fuqi struktura e re organike e cila ka pësuar ndryshime duke u klasifikuar nga IEVP në IMP-IEVP (Institucion Mjekësor i Posaçëm –Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale). Në organikën e re janë parashikuar në total 85 punonjës me uniformë dhe 95 punonjës civil, kjo në përshtatje me orientimin drejt një Institucioni Mjekësor, është ulur numri i punonjësve të policisë dhe është shtuar numri i stafit mjekësor.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përgjigje të rekomandimeve për vitin 2024 bën me dije se është ngritur një grup pune me urdhrin e përbashkët nr.53, datë 31.01.2024 ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.590, Prot datë

31.01.2024 dhe Ministrisë së Drejtësisë nr.669, Prot datë 02.02.2024, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e planit të përbashkët të veprimit për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, aneks i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe monitorimi i zbatimit të tyre”. Gjithashtu ky grup pune do të identifikojë një strukturë akomoduese të përshtatshme për trajtim të denjë të 420 personave me masë mjekësore.

Avokati i Popullit dëshiron të shprehë rezerva në lidhje me planifikimin e Institucionit të ri mjekësor me kapacitet prej 420 shtretër për personat me masë mjekësore, që është afërsisht 30 shtretër nën numrin e kërkuar për të akomoduar numrin aktual të pacientëve burra të mbajtur në IEVP-Lezhë, pa përmendur pacientet gra në Spitalin e Burgut Tiranë.

Sjellim në vëmendje gjithashtu se Institucioni i ri i Posaçëm Mjekësor, duhet të përmbushë rolin e tij si qendër trajtimi për personat me çrregullime të shëndetit mendor që e kanë domosdoshmëri trajtimin nga mjeku specialist psikiatër dhe nga ekipi multidisciplinar, në çdo kohë duke ofruar një mjedis të përshtatshëm terapeutik, sikundër KPT ka theksuar “prania e hekurave dhe rojeve të armatosura krijon një atmosferë shtypëse, jo të favorshme për ngritjen e një mjedisi terapeutik, ose për mbizotërimin e një karakteri mjekësor dhe jo penal”. Avokati i Popullit ka rekomanduar ndër vite marrjen e masave për vënien në zbatim të Planit të Përbashkët të Veprimit për trajtimin e personave me masë mjekësore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, për trajtimin e personave me masë mjekësore, me aktivitete specifike dhe me afate kohore konkrete për këta persona, sipas angazhimeve të marra në marrëveshjen e përbashkët, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Një problematikë tjetër, që u ngrit nga stafi social gjatë inspektimit ishte braktisja e personave me vendim gjykatë, kurim ambulator, nga familjarët e tyre dhe për pasojë rikthimi i tyre në institucion si persona me masë mjekësore.

Për shkak të kontingjentit të akomoduar në institucion, ku aktualisht lista emërore e shtetasve me masë mjekësore të braktisur nga familjarët është 126 persona, Sektori i Çështjeve Shoqërore ka punuar në drejtim të bashkëpunimit me OJF-të e shoqata të ndryshme për t’i ardhur në ndihmë këtyre shtetasve. Vlen të theksohet se Kisha Katolike luan një rol bazë në sigurimin e veshmbathjeve në sasi të mëdha për të gjithë kategorinë e akomoduar në institucion. Përgjatë vitit 2024 institucioni në bashkëpunim me Kishën Katolike ka marrë iniciativën që të kryejë të gjitha procedurat ligjore për ti strehuar në qendrat humanitare që zotëron Kisha. Deri më tani është mundur strehimi i një shtetasi dhe pritej përfundimi i procedurave dhe për dy të tjerë.

Avokati i Popullit thekson se kjo problematikë vazhdon prej vitesh dhe kërkon një zgjidhje të menjëhershme në respektim të të drejtave të njeriut, për të mundur kalimin e personave të braktisur nga familjarët që qëndrojnë në IEVP Lezhë nga godinat 4 dhe 5 në kujdesin e strukturave dhe qendrave të kujdesit social shtetëror dhe të pushtetit vendor.

Gjatë inspektimit, u konstatua se gjendja aktuale e godinave 4 dhe 5 të parashikuara për spital paraqitej si më poshtë vijon:

Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit IEVP Lezhë në datë 3 prill 2025, Avokati i Popullit konstatoi se në seksionin e personave me masë mjekësore **ishin akomoduar në total 461 persona**, (nga 444 që ishin në vitin 2024), nga të cilët:

- 302 shtetas me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, (nga 308 që ishin në vitin 2024)
- 159 shtetas me masë mjekësore “shtrim i përkohshëm”, (nga 132 në vitin 2024)

Nga të dhënat e administruara në ditën e inspektimit Avokati i Popullit konstaton se situata e mbipopullimit të shtetasve me masë mjekësore është në nivele alarmante referuar kapacitetit. Referuar numrit të pacientëve i cili vijon të rritet, kushtet e jetesës në objektin e përkohshëm Lezhë mund të degradojë lehtësisht edhe më tej, deri në një trajtim çnjerëzor dhe poshtërues.

Në objektin e IEVP-së Lezhë janë të vendosura ndërtesat 4 dhe 5 me tre kate. Kati përdhes, dhe kati i parë dhe i dytë janë të pajisur me shtretër, të destinuar për mbajtjen dhe trajtimin e shtetasve me masë “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” me **një kapacitet zyrtar prej 280 pacientësh, në ditën e inspektimit dt.03.04.2025, kishte 461 pacientë meshkuj.**

Akomodimi i këtyre personave me masë mjekësore në IEVP, trajtimi dhe akomodimi jo adekuat i personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” të vendosur nga gjykata, mbi kapacitetin fizik në IEVP Lezhë, është denoncuar vazhdimisht nga institucioni i Avokati i Popullit, si një shkelje flagrante e ligjit dhe e standardeve ndërkombëtare, që sjell trajtim diskriminues dhe denigrues të këtyre pacientëve si dhe përkeqësim të gjendjes së tyre shëndetësore.

Në lidhje me situatën dhe problematikat në të cilën ndodheshin personat e akomoduar në IEVP Lezhë, A.P ka shprehur shqetësimin e tij në lidhje me kapacitetet akomoduese të kësaj strukture, si dhe ka përsëritur nevojën për kompletimin me staf shëndetësor shtesë, sipas standardeve dhe protokolleve shëndetësore për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor.

Organika në IEVP Lezhë paraqitej si më poshtë, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit, Nr.prot.68, datë 30.04.2024, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj*”.

Punonjës civil 95 persona ndër të cilët:

- Sektori ligjor me 7 punonjës
- Sektori i çështjeve shoqërore me 11 punonjës ndër të cilët 1 përgjegjës sektori dhe 5 punonjës psikolog dhe 5 punonjës social.
- Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve 20 punonjës nga të cilët 10 janë kujdestarë (për pacientët me masë mjekësore) dhe 10 sanitarë.

- Sektori i Kujdesit Shëndetësor 33 Punonjës
 - Mjek i Përgjithshëm /Mjek Specialist – 5 Mjek
 - Mjek Psikiatër – 5 Mjek (2 Mjekë Psikiatër me kohë të plotë 3 Mjek Psikiatër part time)
 - Mjek Kardiolog- 1 Mjek
 - Mjek Laborant Biokimik – 1 Mjek
 - **Mjek Stomatolog – Në Mungesë**
 - Kryeinfermier – 1 punonjës
 - Infermier - 18 punonjës **1 ndër ta në mungesë**
 - Infermier /Laborant – 1 punonjës

- **Stafi për sektorin e policisë përbëhej nga 85 punonjës sigurie.**

Vakancat në institucion janë: 1 Specialist Ushqimi, 1 Kuzhinier, 1 Mjek Stomatolog, 1 Infermier.

Përgjatë inspektimit konstatuam gjithashtu se për 24 orë shërbim, ishin në shërbim vetëm 2 kujdestarë për 461 persona, çka tregon se numri i kujdestarëve në turn shërbimi është i pamjaftueshëm për të ofruar shërbimin një numri të lartë pacientësh me masë mjekësore.

Në Planin e Veprimit për Shëndetin Mendor 2023-2026, MSHMS ka përcaktuar objektiva specifike:

- Ofrimi i shërbimit të specializuar psikiatrik mbështetës për stafin e Institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë nëpërmjet angazhimit të mjekëve, sipas nevojave;
- Sigurimi i diagnostifikimit (ekzaminimeve kliniko-biokimike, imazherike, konsultave të specializuara, etj) dhe trajtimit të specializuar (ndërhyrje kirurgjikale, etj) për problematika të ndryshme shëndetësore të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të akomoduar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë, nëpërmjet Spitalit Rajonal Lezhë dhe strukturave të tjera spitalore universitare;
- Ofrimi i ekzaminimeve laboratorike, depistimeve epidemiologjike dhe asistencë për diagnozë, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, sipas nevojave të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të akomoduar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë.

Gjithashtu në Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030, MSHMS ka përcaktuar masa konkrete për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor për të cilët gjykata kompetente ka dhënë masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Gjithashtu përcaktohet si një nga veprimet konkrete që duhet ndërmarrë edhe ngritja e institucionit mjekësor të posaçëm për trajtimin e personave me masë mjekësore mjekim i përkohshëm, me kapacitet rreth 350 shtretër funksional.

Por, referuar Planit të Veprimit për Shëndetin Mendor, pavarësisht se parashikohet kryerja e vlerësimeve për çdo pacient, rezulton se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka arritur në një qasje pozitive dhe aktive pasi përgjatë inspektimit konstatohej qartazi braktisja terapeutike e personave me masë mjekësore në IEVP Lezhë **kjo edhe për shkak të numrit të lartë të pacientëve që trajtohen në I.E.V.P. Lezhë.**

Sikurse parashikohet dhe në ligjin nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”, menaxhimi i këtij spitali duhet të kalonte tërësisht nën administrimin dhe kujdesin e MSHMS, për të ofruar ndihmën dhe trajtimin e specializuar përkatës. Kjo masë e marrë aktualisht, mbetet shumë larg plotësimit të këtij detyrimi ligjor.

Për të qenë në gjendje të përmbushë rolin e tij si qendër trajtimi për pacientët me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i detyruar”, Institucioni tranzitor duhet të ofrojë një mjedis të përshtatshëm terapeutik.

Trajtimi

Grupi i inspektimit, kishte për qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave me masë mjekësore që trajtohen në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ankesave, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor, cilësia e ushqimit, furnizimi sipas normativave me detergjente dhe mjete të higjienës personale, etj.

Referuar komunikimit me stafin e I.E.V.P. Lezhë u informuam se në momentin e hyrjes së shtetasit me masë mjekësore në dhomën e këshillimeve ai pajiset me formatin e kërkuar nga ana e stafit, të cilin e plotëson e në rastet kur është i paqartë mbi objektin e kërkuar, shtetasi udhëzohet mbi plotësimin e saj. Kjo kërkesë hidhet pranë postës së Institucionit e cila ndodhet në korridorin e Regjimit të Brendshëm në të dy godinat. Kjo postë menaxhohet nga Sektori i Çështjeve Shoqërore dhe hapet çdo ditë në orën 13:00. Kërkesat regjistrohen më parë nga përgjegjësi dhe më pas dërgohen pranë sekretarisë së Institucionit. Të gjitha kërkesë-ankesat përcillen për njohje dhe ciklim nga ana e titullarit të institucionit dhe më pas i kalohen për veprim përgjegjësve të sektorëve me afate të përcaktuara, në bazë edhe të natyrës së kërkesës.

Komunikimin me telefon me familjet e tyre personat me masë mjekësore e zhvillonin normalisht me telefonat me kartë të vendosur në mjediset e korridoreve në regjimin e brendshëm. Ata ishin në gjendje pune dhe këta persona kryenin 8 telefonata në muaj me familjet dhe të afërmit e tyre.

Kushtet Materiale

Grupi i monitorimit, inspektoi plotësimin e kushteve në ambientet e regjimit të brendshëm të institucionit, sipas kërkesave ligjore dhe në respektim të standardeve më

të mira për jetesë dhe aktivitete të personave me masë mjekësore të akomoduar në këtë institucion.

Gjatë inspektimit, u konstatua se gjendja aktuale e godinave 4 dhe 5 të parashikuara për spital paraqitej si më poshtë vijon:

Në godinat 4 dhe 5 të banuara me shtetas me mase mjekësore rezultojnë të akomoduar 461 shtetas, të sistemuar në 59 dhoma gjithsej, konkretisht:

- **Godina nr.4, kishte kapacitet për shtrimin dhe trajtimin gjithsej të 97 pacientëve** me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Aktualisht, godina nr. 4 ishte 3 kate.
- **Godina 4 kati i parë** ka gjithsej 10 dhoma dhe (1 dhome observim dhe 1 dhome tjetër dhoma e kufizimit fizik.) Gjithsej të akomoduar **43 persona.**
- **Godina 4 kati i dytë** ka gjithsej 12 dhoma banimi, gjithsej të akomoduar **81 persona.**
- **Godina 4 kati i tretë** ka gjithsej 12 dhoma banimi, gjithsej të **akomoduar 84 persona.**

Godina nr. 4 ka të akomoduar **208** persona, ndonëse kapaciteti akomodues është për 97 persona, **111 persona mbi kapacitet.**

- **Godina nr.5 kishte kapacitet për shtrimin dhe trajtimin me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, për 87 pacientë.**
- **Godina 5 kati i parë** ka gjithsej 3 dhoma banimi të populluara me 30 persona.
- **Godina 5 kati i dytë** ka gjithsej 12 dhoma banimi, gjithsej të akomoduar 88 persona.
- **Godina 5 kati i tretë** ka gjithsej 12 dhoma banimi, gjithsej të akomoduar 87 persona,

Godina nr.5 ka të akomoduar **205** persona, ndonëse kapaciteti akomodues është për 87 persona, **118 persona mbi kapacitet.**

Gjithashtu ambientet e ish - SKV-së kishin akomoduar 22 persona dhe ambientet e ish- Infermierisë akomoduar 26 persona. Në total në të gjithë ambientet e banimit ishin akomoduar **461 persona.**

Avokati i popullit shpreh shqetësimin se mbipopullimi është në dyfish të kapaciteteve të I.E.V.P Lezhë në ditën e inspektimit të gjitha dhomat e banimit ishin mbikapacitet dhe numri i tyre shkonte deri në 12 persona. Me një kapacitet zyrtar prej 280 pacientësh, objekti i përkohshëm është i mbipopulluar, si rezultat në qeli të caktuara më pak se 3.2 m² hapësirë jetese për person.

Gjithashtu përgjatë inspektimit konstatuam se ambienti i godinës së vjetër ku më herët ka funksionuar si ambiente infermierie dhe ambiente për ish takimeve speciale tashmë ishte kthyer në ambient banimi për personat me masë mjekësore. Në këto ambiente ishin akomoduar 17 persona. Ky sektor është jashtë standardeve dhe në kushte çnjerëzore për të mbajtur e trajtuar persona me masë mjekësore. Dhomat janë me lagështirë të theksuar, tualetet dhe dushet jashtë funksionit. Dyert e dhomave të personave me masë mjekësore janë me pjesë xhami, gjithashtu në dhoma ka litarë që shërbenin për tharjen e rrobave çka tregon qartë se këto elementë mund të kthehen në çdo moment rrezik për vetëdëmtimin e tyre.

Kapaciteti maksimal i përcaktuar për të dy godinat ka qenë për 184 persona, por me shtesat në shtretër për të rritur **kapacitetet akomoduere është për 280** persona. Në ditën e inspektimit, në mjediset e **institucionit ishin 461 persona**, pra me një **mbipopullim prej 181** personash mbi kapacitet.

Dhoma e kufizimit fizik në Godinën nr. 4 ishte e pajisur rishtazi me 3 shtretër sipas standardeve, të parashikuara me ligjin nr. 44/2012, dt. 01.06.2012. “Për Shëndetin Mendor”. Regjistri i posaçëm për personat që do të kufizohen ishte i mbajtur dhe i sekretuar.

Në katin e parë të Godinës nr.5 ishin të vendosura klinikat mjekësore të mjekëve, laborator, dhomë për këshillim psiko-social, dhomat e infermierëve, për personelin mbështetës (sanitar dhe kujdestarë), si dhe ambiente për punën e administratës.

Në katet e dyta dhe të treta të Godinave nr. 4 dhe 5 ku akomodohen personat me masë mjekësore, mungonin ambientet për trajtimin e tyre si këshillim terapeutik, konsulta në grup dhe punë kreative.

Në godinat 4 dhe 5 kishte nga një dhomë për secilën godinë dhomat ishin të pajisura me televizor dhe karrige, ku nga sektori social ishte planifikuar që të përdorej në grupe të vogla.

Dhomat e banimit ishin të pajisura brenda me tualete, të cilat në përgjithësi kishin mungesë të theksuar higjienë kjo për shkak të mbipopullimit të dhomave. Nga inspektimi u konstatua se dyshekët ishin të vjetërsuar dhe jashtë standardeve, ato ishin të përbëra nga një shtresë e hollë sfungjeri të dëmtuar dhe të papërshtatshëm, në disa nga dhomat mungonin jastëkët, tavolinat për ngrënie. Pacientët me masë mjekësore u konstatuan nga grupi i inspektimit se pjatat me ushqim i vendosnin në tokë për tu ushqyer. KPT rekomandon që autoritetet shqiptare të bëjnë përpjekje për⁵:

- *sigurimin e një mjedisi më të përshtatshëm dhe të personalizuar për pacientët*
- *sigurimin e shtretërve të plotë, duke përfshirë çarçafët, përveçse nëse ka kundër indikacione personale bindëse;*
- *pajisjen e qelive të pacientëve me tavolina dhe stola në përpjesëtim me numrin e pacientëve që akomodohen në qeli, dhe me hapësirë ruajtjeje me kyç, ku pacientët mund të ruajnë sendet e tyre personale.*

⁵ Raport Drejtuar Qeverisë Shqiptare Mbi Vizitën E Kpt Në Shqipëri Të Kryer Në Datat 4-15 Maj 2023.

Përgjatë inspektimit konstatuam se në të dy godinat **mungonte tërësisht ngrohja e ambienteve** të banimit.

Ambienti i dusheve për larjen e trupit ishte i përbashkët dhe ndodhej në fundin e korridorit të çdo sektori, ku secili kat godine ishte i planifikuar për 12 dushe ndërkohë funksional ishin vetëm 4 dushe për 82 persona të akomoduar në sektor. Avokati i Popullit konstaton se numri i dusheve funksionalë nuk është në proporcion dhe nuk i përgjigjet kërkesave referuar numrit të personave që janë të akomoduar në çdo sektor.

Në kuzhine punonin tre kuzhinierë nga 4 të miratuar në organikë pasi 1 kuzhinier ishte vendi vakant. Kuzhina ishte në katin e parë të hapësirës së ndërmjetme të godinës, dhe kishte nivel të lartë të lagështirës.

Ambienti kishte nevojë për lyerje dhe mirëmbajtje. Menyja e përditshme ishte e afishuar sipas gramaturave dhe ishte e larmishme. Përgjatë inspektimit konstatuam se, kampionet e ushqimit ishin të paetiketuar, për çdo vakt ushqimi.

Lavanderia ndodhej në ambient më vete në I.E.V.P. Shënkoll, Lezhë dhe ishte funksionale. Në funksion ishin 3 lavatrice dhe 1 tharëse teshash. Kjo lavanderi ishte për godinën 4 dhe 5 si dhe për godinën nr.1. Nga inspektimi konstatuam se numri i lavatriçeve ishte i pamjaftueshëm referuar numrit të lartë të personave të akomoduar në I.E.V.P Lezhë.

Ambientet e ajrimit ishin, mbuluar me strehë mbrojtëse, që bënë të mundur që dhe në ditët me shi dhe kohë të keqe personat e akomoduar aty të dilnin në këto ambiente.

Aktivitetet e personave me masë mjekësore

Në godinën nr.4 dhe godinën nr. 5 ka nga 1 dhomë për secilën godinë për zhvillimin e aktiviteteve. Aktualisht këto dy dhoma ishin të pajisura me nga 1 televizor dhe me karrige si dhe disa tituj librash ë vendosur në rafte.

Spektori i çështjeve shoqërore ka punuar në drejtim të bashkëpunimit me OJF-të e shoqata të ndryshme për t'iu ardhur në ndihmë personave që janë braktisur nga familjarët ose vijnë nga familje me nivel shumë të ulët social- ekonomik.

Funksionimi i veprimtarive ditore dhe programeve të tjera rehabilituese, si dhe angazhimi i plotë i shtetasve me masë mjekësore kryhet pjesërisht, kjo për shkak dhe të numrit të madh të personave të akomoduar. Në kuadër të ruajtjes së higjienës, sektori i çështjeve shoqërore punon edhe në motivimin dhe edukimin e mënyrës së ruajtjes së higjienës vetjake dhe jo vetëm, si pjesë e programit terapeutik okupacional.

Pavarësisht situatës, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, procesi i edukimit nuk duhet të ndërpritet, pasi ka një rëndësi të veçantë në rehabilitimin dhe riintegrimin e personave. Ky proces, duhet të përfshijë programet e trajtimit individual, por dhe punën në grupe, duke marrë në konsideratë nevojat individuale psikologjike, shoqërore, moshën, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar, veprën penale si dhe faktorët e riskut.

Ka nevojë të shtohet kapaciteti njerëzor dhe burimet financiare për të mundësuar zhvillimin e këtyre aktiviteteve për të dyja godinat.

Me organizimin e aktiviteteve për personat me masë mjekësore është i ngarkuar Sektori i çështjeve shoqërore, i cili ka punuar në drejtim të programeve të trajtimit, të individualizuara apo në grupe të vogla të përbërë nga 4-5 persona dhe këto programe përfshinin: Mbështetje, ndihmë dhe monitorim i personave me probleme të shëndetit mendor, mbështetje, ndihmë dhe monitorim për personat që kanë varësi nga substancat narkotike, mbështetje, ndihmë dhe monitorim i personave me tendenca suicidale/vetëdëmtuese.

Përgjatë inspektimit u informuam se, pacientët me masë mjekësore dilnin në oborrin e jashtëm, në të cilën ishin vendosur dhe tendat, në oraret midis orës 09:00 dhe 12:00.

KPT rekomandon që të gjithë pacientëve në ambientet e përkohshme t'u sigurohen një program trajtimi multi-disiplinor (përveç farmakoterapisë) që përbëhet nga një sërë aktivitetsh terapeutike, duke përfshirë aktivitete terapeutike profesionale dhe të tjera psikosociale dhe aktivitete rekreative, të përshtatur për nevojat specifike të kategorive të ndryshme të pacientëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit thekson rëndësinë që ka rehabilitimi dhe riintegrimi i këtyre personave. Ky proces, duhet të përfshijë programet e trajtimit individual, por dhe punën në grupe, si dhe një gamë të gjerë aktivitetsh terapeutike, rehabilituese dhe rekreative, me ekipe multidisiplinare, duke përfshirë terapinë psiko-sociale dhe kujdesin e duhur mjekësor. Puna individuale apo në grupe nga ekipi psiko-social në koordinim me mjekët psikiatër, të cilët duhet të mjekojnë simptomat e sëmundjes, duhet të programohet me periudha të përkohshme leje të (pa)shoqëruar, në një kohë të përshtatshme kur gjendja e pacientit e lejon.

Avokati i Popullit thekson se kartat e të drejtave të pacientëve me masë mjekësore ishin pothuajse inekzistente në të gjitha ambientet.

Shërbimi shëndetësor

Shërbimi shëndetësor ndodhej në katin e parë të godinës nr.5, ndodhej dhoma e vizitave të mjekut, dhoma e stomatologut, farmacia dhe dhoma për konsultat ditore dhe rastet e urgjencës. Dhomat e vizitave ishin të plotësuara me krevatet dhe shtroje, në kushte të mira higjieno-sanitare. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me autoklavë dhe poltron të ri por ishte jashtë funksionit pasi mungonte stomatologu në institucion për ofrimin e shërbimeve të nevojshme.

Grupi i inspektimit, konstatoi se institucioni ishte plotësuar me një laborator klinik bio-kimik, që ishte vënë në funksion dhe ishin plotësuar mungesat që ishin një vit më parë të reagentëve dhe tubave, të cilat janë materiale mjekësore për realizimin e analizave të pacientëve. Institucioni ishte pajisur me shtretër të kufizimit fizik dhe këmisha, janë pajisur me Defribilator dhe EKG (Elektrokardiograme). Nga biseda me shefin e sektorit shëndetësor na informoi se për përdorimin e defribilatorit nevojitet që të trajnohen infermierët për përdorimin sa më efikas të tij.

Furnizimi me medikamente për sëmundjet kronike dhe për rastet urgjente, bëhej sipas skemës së rimbursimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe me ilaçe të siguruar nga fondi i veçantë në dispozicion të Institucionit. Në ditët e inspektimit ilaçet ishin brenda afatit të skadencës, dhe nuk kishte mungesa.

Nga këqyrja e dokumentacionit rezultoi se, si regjistri për vizitat e kryera nga stafi mjekësor i institucionit ashtu dhe regjistri i të sëmurëve kronikë për konsultat jashtë institucionit, ishte i plotë. Gjithashtu, në dhomën e mjekut ndodhej edhe “Libri për ekzaminimin e rasteve të keqtrajtimit dhe të dhunës”. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, ishin plotësuar sipas rubrikave. Në kartelat mjekësore të pacientëve nuk ishin të atashuara edhe vlerësimet e stafit psiko-social, që kryhej një herë në 6 muaj dhe binte në sy mungesa e Mjekut Psikiatër në Komisionin e vlerësimit të sjelljes.

Rishikimi i masave mjekësore

Nga inspektimi i kryer në IEVP-Lezhë rezultoi se:

- **302** shtetas me masë mjekësore “mjekim i detyruar”,
- **159** shtetas me masë mjekësore “shtrim i përkohshëm”,

Gjatë inspektimit shtetas të ndryshëm që trajtohen në këtë institucion, ngritën pretendimin se tashmë gjendja e shëndetit mendor të tyre ka përmirësim të dukshëm pas trajtimit mjekësor me terapi dhe medikamente, kjo e konfirmuar edhe nga stafi psiko-social.

Për kategorinë e personave që janë me çrregullime të shëndetit mendor dhe kanë kryer veprë penale dhe trajtohen me masën mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor” apo “Mjekimi i detyruar ambulator”, referuar nenit 46, paragrafi i dytë, të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, *“Vendimi gjyqësor për masat mjekësore dhe edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë, por në çdo rast, gjykata, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj”*, duhet të behet rivlerësimi vjetor nga gjykata për gjendjen e tyre shëndetësore.

Nga ana e IEVP-së Lezhë në muajin Janar 2025 ishte dërguar informacion Gjykatave, për të kryer rivlerësimet për 150 pacientë, për të cilët kishin kaluar afatet e rivlerësimit të masës mjekësore nga data e dhënies së vendimit të fundit (**jemi në kushtet e kalimit të afateve**). Nga dosjet që janë dërguar për rivlerësim nga Gjykatat janë marrë në shqyrtim deri në Mars 2025 rreth 34 dosje të pacientëve me masë mjekësore.

Në IEVP-Lezhë funksiononte një Komision i përbërë nga 5 punonjës të stafit psiko-social, ligjor dhe të sigurisë, të cilët bënin një herë në 6-muaj, vlerësimin e sjelljes së personave me masë mjekësore. Nga ana e stafit psiko-social na u konfirmua që raportet që ata mbajnë për këtë kategori personash nuk merren parasysh në fazën që bëhet rivlerësimi vjetor.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe nenin 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive;*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për uljen e mbipopullimit në këtë institucion duke siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, sigurimin e shtretërve të plotë dhe kushteve higjieno-sanitare brenda vitit 2025.
2. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për hartimin/miratimin e rregullores së funksionimit të Institucionit Tranzitor Lezhë, deri në ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor.
3. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për plotësimin e vendeve vakante në Institucion si: Mjek stomatolog, Infermier dhe kuzhinier.
4. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për shtimin e të paktën 1 Mjeku - Psikiatër me kohë të plotë në organikën e Institucionit.
5. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për shtimin e numrit të kujdestarëve në institucion kjo referuar numrit prej 461 personave të akomoduar në IEVP Lezhë.
6. Marrjen e masave nga I.E.V.P Lezhë për nxjerrjen jashtë funksionit të ambienteve të ish - infermierisë të cilat janë kthyer në ambiente banimi.
7. Marrjen e masave nga I.E.V.P Lezhë për sigurimin e ngrohjes për personat me masë mjekësore si dhe vënien në funksion të sistemit ngrohje-ftohje të ambienteve.
8. Marrjen e masave nga I.E.V.P Lezhë për pajisjen e dhomave të banimit me tavolina dhe dollapë për mbajtjen e teshave.
9. Marrjen e masave nga IEVP Lezhë për kryerjen e lyerjeve dhe dezinfektimeve të dhomave të banimit.

10. Marrjen e masave nga I EVP Lezhë, për pajisjen e të gjitha dhomave të banimit me dyshekë sipas standardeve dhe zëvendësimin e atyre aktualë (prej sfungjeri) me dyshekë të rinj, si dhe pajisjen me jastëkë të të gjithë dhomave të banimit.
11. Marrjen e masave nga I.E.V.P Lezhë për etiketimin e kampionëve ushqimor sipas procedurës dhe zëvendësimin e mjeteve të gatimit në kuzhinë.
12. Marrjen e masave nga sektori i çështjeve shoqërore në institucion për zhvillimin e asistencave psikologjike dhe këshillim në grup dhe individual si dhe zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese në konsultim me stafin mjekësor në institucion.
13. Marrjen e masave nga I.E.V.P Lezhë për pajisjen e ambienteve të institucionit me kartat e të drejtave të pacientëve me masë mjekësore.
14. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për trajnimin e infermierëve në institucion, për mundësimin e vënies në funksion të defribilatorit.
15. Marrjen e masave nga I.E.V.P Lezhë për angazhimin e stafit psiko-social në bashkëpunim me mjekët psikiatër duke vepruar si një ekip multidisiplinar, për përcaktimin e planeve individuale për pacientin dhe organizimin e një karteletë të përbashkët për pacientin për të bërë të mundur një rishikim të rregullt të gjendjes së shëndetit mendor të pacientit dhe një rishikim të mjekimit të pacientit.
16. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror si dhe nga pushteti Vendor për kalimin e personave të braktisur nga familjarët që qëndrojnë në I EVP Lezhë nga godinat 4 dhe 5 në kujdesin e strukturave dhe qendrave të kujdesit social shtetëror si dhe qendrave në administrim nga pushteti vendor.
17. Marrjen e masave nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për planifikimin e ngritjes dhe funksionimit të Institucionit Mjekësor të Posaçëm, si strukturë e posaçme për ofrimin e një kujdesi terapeutik, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, si dhe informimin e institucionit tonë në lidhje me Planin e Veprimit të përbashkët për trajtimin e personave me masë mjekësore, për detajimin e aktiviteteve specifike me afate kohore konkrete, sipas angazhimeve të marra në marrëveshjen e përbashkët, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
18. Marrjen e masave nga I.E.V.P Lezhë për përgatitjen e dosjeve të personave me masë mjekësore, 2 muaj para përfundimit të afatit të rivlerësimit, në mënyrë që gjykata të ketë kohë ti planifikojë e marrë vendimet brenda kohës së kufizimit.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA

DV